



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 4513/2021
Data: 22.06.2021

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbal nga mbledhja e pestë -V- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 27.05.2021 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: Rufki Suma (Kryetar i Komunës), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Bajrush Laçi (Shef i Zyrës Ligjore), Ibrahim Axhami (Asistent i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), Bashkim Sopa (Zyrtar për Informim). Kryesuesi i kuvendit pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se anëtarja e kuvendit të komunës znj. Teuta Shkreta është i lidhur me zoom për shkak të angazhimeve të cilat i ka është arsyetuar, ndërsa anëtarët e tjerë të gjithë janë prezantë.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Informatë rreth gjendjes së koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit.
3. Kërkesa e kompanisë "Elkon" sh.p.k për dhënien e pëlqimit në parim.
4. Informatë mbi mbrojtjen e mjedisit.
5. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sead Vila thekson:- jam anëtarë apo delegat apo delegat i kuvendit themelues të shoqatës së pedagogëve të sportit dhe përveç takimeve të zgjedhjes së kryesisë takim tjetër nuk kam pas, por aty është një rregulllore dhe janë të specifikuara disa detyra dhe përgjegjësi. Shkollat tona marrin pjesë nëpër gara kommunale, regionale dhe republikane për sport, kjo është e mirë sepse ka shumë dobi shëndetësore dhe i largon të rinjët nga dukuritë negative. Po më brengosë se neve po na mungon shpirti ideal për me punuar me këta nxënës dhe jemi materializuar pak si shumë. Nëse i marr ndonjë fëmije, nxënësi mjete financiare po më duket se është konflikt interesit, megjithë atë unë merrem nga pak me sport dhe mund të kontribojojë vullnetarisht sipas mundësive, por kërkoj të xhindet formë për tu kompensuar këta për punën që bëjnë e jo nëpërmjet nxënësve. përveç punës si mësimdhënës punës si mësimdhënës në orar të rregullt, duhet të gjejnë kohë edhe jashtë orarit për të punuar me ata fëmijë që kanë shkathtësi dhe talent, si në arsim e njëjtë duhet të vlejë edhe në sport. kërkoj që mos të anashkalohet shoqata e pedagogëve të sportit dhe çdo aktivitet i sportit të jetë në suaza të kësaj shoqate, ky nuk është shqetësim individual, më shumë është shqetësim kolektiv sepse shumë prindër kanë kërkuar që unë këtë çështje me paraqitur në kuvendin e komunës. porosia është, në fillim të bëhet punë vullnetare e pastaj të xhindet formë e financimit nga komuna për këta mësimdhënës të sportit për punën që po bëjnë.

Florim Shkreta thekson:- te diskutimi imë fjala keqpërdorim të zëvendësohet me fjalën dhe të jetë ka gjasa që minden me u vjedhë ndihmat gjatë shpërndarjen në orë policore e jo me u keqpërdore sepse për me u keqpërdorë dihet që janë keqpërdor.

Mehmet Ballazhi thekson:- më pëlqeji forma e votimit që është shënuar se kush është për dhe kush është kundër dhe është mirë që të vazhdon kjo mënyrë e paraqitjes.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Informatë rreth gjendjes së koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Rufki Suma thekson:- vërehet se gjendja me pandeminë është në rënien sepse nëse shkohet në ambulantë nuk shihet asnjë pacient që është me simptoma të kovidit. Gjatë muajit majë nuk kemi pasur asnjë rast që ka dal pozitiv. Deri më tani janë bërë 1810 teste serologjike. Në muajin maj 184 qytetarë janë vaksinuar me vaksina antikovid dhe numri i përgjithshëm që deri më tani janë vaksinuar janë 438 qytetarë që janë vaksinuar. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Mefail Suma thekson:- me datë 15 e kam marr vaksinën dhe më kanë udhëzuar por nuk i kam dëgjuar mirë për shkak problemeve me dëgjim që kam, mirëpo ish dashur me i përdorë dy paracetamolla në mënyrë që mos me pasur ethe për shkak se nga ora 23:00 e deri në mëngjes kam pasur ethe. Të nesërmen kur kam shkuar te mjeku të njëjtë persona të cilët ishin në sallë ditën kur e kam marr vaksinën ishin edhe ditën kur ka shkuar dhe infermierja ka qenë duke punuar diçka, mirëpo aji që ishte me mjeken ka bërë një tallje dhe është ngritur në këmbë dhe ka shprehur një lloj mimike që unë konsiderojë që mi ka shkelur të drejtat e pacientit. Është mirë që me ju térhequr vërejtja stafit në QKMF që me u sjell mirë ndaj pacientëve.

Florim Shkreta thekson:- si shkon mënyra e vaksinimit.

Mehmet Ballazhi thekson:- si është procedura e sigurimit të vaksinës.

Rufki Suma thekson:- ata të cilët kanë vërejtje ndaj stafit në QKMF është mirë me parashtruar ankesë me shkrim sepse edhe institucioni nuk mundet me marr masa ndaj stafit nëse nuk ka ankesa me shkrim. Vaksinat fillimi shjanë dhënë për stafin shëndetësore dhe është marr përsipër numri i stafit. Sipas informatave që kam vaksina do të sigurohen për qytetarët në bazë të numrit të banorëve që janë. Sa i përket formës fillimi shjanë vaksinuar personat e moshës 80 deri në 85 vjet pastaj ka rënë mosha deri në 60 vite për shkak se ata të cilët janë ftuar për me u vaksinuar një pjesë e tyre nuk ju kanë përgjigjur ftesës. Nëse hapet epruveta patjetër duhet të jenë dhjetë doza dhe ka persona që paraqiten vullnetarisht mi marr vaksinat dhe nëse ftohen numri i personave që janë të regjistruar në listën për vaksinim dhe nëse ndonjëri prej tyre nuk paraqitet e për mos me mbetur pa u shfrytëzuar, ka mundur me u ftuar dikush i cili ka qenë në listën e pritjes.

Florim Shkreta thekson:- e parashtrova këtë pyetje më lartë për shkak se ka pasur ankesa nga qytetarët për shkak se persona më të ri po vaksinohen e po anashkalohen ata të cilët janë më të moshuar.

Kryesuesi thekson:- kur të çelen dhjetë doza planifikohen për personat mbi moshën gjashtëdhjetë vjeçare dhe iks raste ndodhin që disa prej tyre refuzojnë me marr vaksinën dhe dozat të cilat nuk minden me u shfrytëzuar duhet të hedhen në mbeturina, stafi i QKMF-së për mos me i hedhë në mbeturina e fton diken për me u vaksinuar dhe mendoj që nuk është keqpërdorim sepse më mirë është me ja dhënë dikujt se sa me hedh në mbeturina .

Florim Shkreta thekson:- kjo përgjigje nuk takon me dhënë si kryesues i kuvendit për shkak se nuk je drejtore shëndetësisë dhe është keç menaxhim se pse e hap atë paketë kur nuk është numri për me i vaksinuar.

Mefail Suma thekson:- unë jam në moshën shtatëdhjetë vjeçare dhe dua ti tregojë kryetarit të komunës që kjo është e vërtetë por stafi shëndetësorë paguhet për me kryer shërbime në QKMF. Gjatë kontrollës që kam pasur te mjekja i kam shprehur shqetësimet që nuk është mirë për bashkëbiseduesen tende me u shprehur në atë mënyrë me mimikë ndaj pacientit. E paraqita këtë rast në mënyrë që të dihet që ka persona në QKMF që bëjnë hajgare me pacientët.

Isni Bushi thekson:- në muajin e kaluar prej institutit kam dal pozitiv dhe të nesërmen kam bërë testin në QKMF dhe kam dalur negativ. Dua ta falënderoj stafin e QKMF-së sepse kanë pasur një sjellje shumë të mirë dhe korrekte. Edhe pse isha pa asnje shejë janë interesuar për gjendjen shëndetësore timen, përsëri e kam bërë testin serologjik dhe kam dal negativ por mendoj se është një keqkuptim i institutit. Instituti nuk është interesuar për gjendjen time shëndetësore dhe është mirë që me biseduar me institutin për këtë çështje për shkak se mendoj që është bërë ndonjë gabim te rasti imë dhe drejtoria e shëndetësisë është mirë me biseduar me institutin për këtë çështje.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

3. Kërkesa e kompanisë “Elkon” sh.p.k për dhënien e pëlqimit në parim.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhemdin Daci thekson:- në vitin 2019 kuvendi i komunës i ka dhënë pëlqim kësaj kompanie, mirëpo kompania ka bërë kërkesë për një parcelë tjetër e cila është afér asaj që është dhënë në vitin 2019. Përfaqësuesi i kompanisë është prezent në mbledhje dhe për më shumë mund të jep sqarime në detaje.

Rashid Krasniçi (përfaqësues i kompanisë Elkon) thekson:- pikat kadastrale që na i ka dhënë komuna nuk po përputhen me kërkesat tona dhe arsyen e dytë është se vendimit i ka dal afati për shkak se sipas ligjit validiteti i vendimit të komunës është dy vite. Arsyja e vonesë që i ka dal validiteti vendimit ju i dini problemet të cilat kanë qenë për hidrocentralet. Kemi parashtruar kërkesë në institucionet e nivelit qendrorë dhe jemi pajisur me dokumentacione por në kërkesën për pëlqim mjedisorë është dashur të jenë të precizuara pikat se ku ka me u ndërtuar në mënyrë që të jenë të harmonizuara me pëlqimin e komunës. këto dy pika janë rekomanduar prej Ministrisë së Ambientit për shkak se është vend më i përshtatshëm sepse pronat e ujut janë me gjerësi më të madhe në këto pika dhe si vend është më i përshtatshëm e nuk preken pronat private.

Nora Xhoni thekson:- u potencua që bizneset private nuk dëmtohet, mirëpo skicën e kemi dëgjuar që pika ka shkuar shumë afér terasës së biznesit dhe e prekë biznesin shumë afér. Personalisht nuk dua që ai biznesi me u prekë aty.

Rashid Krasniçi (përfaqësues i kompanisë Elkon) thekson:- bëhet vetëm një akumulim te kjo pika dhe vetëm çka bëhet më bukur dhe nuk i vërvshohet. Asnjë afekt negativ për komunën nuk ka me qenë dhe rrëth akumulimi do të bëhet një stazë dhe një ndriçim por do të bëhet edhe një shëtitore rrëth asaj. Pas rregullimit të dokumentacionit do të aplikojmë në komunë për leje të ndërtimit dhe precizohet saktë se ku ka me u ndërtuar dhe nuk ka me u dëmtuar askush përvëç se gjatë ndërtimit mund të ketë ndonjë pengesë nga makineritë që do të punojnë apo mund ta bllokojnë rrugën deri sa të kryen punë. Në momentin që do të kryhen punimet qyteti ka me u zbuluar dhe nuk do të ketë diçka të keçe.

Florim Shkreta thekson:- biznesi i cili është momentalisht aty është duke i zhvilluar disa punime dhe besoj që ndoshta ka leje që punon dhe mund të dëmtohet nëse zhvillohen punimet aty nga kjo kompani

Rashid Krasniçi (përfaqësues i kompanisë Elkon) thekson:- servitutin e kemi prej Ministrisë prej fillimit deri në fund të lumbit dhe nëse afektohet biznesi mund të lëshohemi edhe më poshtë ku nuk pengon përfundimisht do të caktohet me leje nga Drejtoria e Urbanizmit. Nëse ju e votoni që me na u dhënë pëlqimi do të bëhet edhe diskutimi publik me Ministrinë e Ambientit dhe nuk lejohet me u ndërtuar diçka që është në dëm të biznesit dhe në dëm të popullatës .

Mehmet Ballazhi thekson:- si lëndë qëndron si kërkesë për hulumtim të potencialit ujorë e më vonë shënon që me mundësi ndërtimi dhe është mirë me modifikuar titullin e lëndës. Nëse ju kujtohet edhe dy vite më herët nuk kemi bërë pengesë. Kërkoi sqarim për atë që është shënuar Elez Hani 1 dhe Elez Hani 2. Është mirë që mos me cenuar biznesin që është aty afér por edhe investimet në komunitet do të ishin të mirëseardhura. Unë jetojë në atë lagje dhe është një lagje me investime më sa paku që janë bërë. Është mirë që të investoni në lidhje me rregullimin e ambientit sepse është me rëndësi se Hani i Elezit sa i përket ambientit është ndër komunat më të dobëta . Në emër të grüpuit tim parlamentarë dhe të anëtarëve të kuvendit kërkojë që të jeni serioz për me investuar. A jeni për momentin dikund me projekte te tilla që jeni duke funksionuar nëpër Kosovë.

Rashid Krasniçi (përfaqësues i kompanisë Elkon) thekson:- bëhet fjalë për dy hidrocentrale . Sa i përket efikasitetit e kemi vullnetin për me punuar por ky është projekt i vogël por ka kosto të lartë . Ne jemi ortakë me një kompani tjeter e cila i ka tri hidrocentrale në Mitrovicë por të tipit të tillë jo dhe ky do të jetë i pari në Han të Elezit.

Florim Shkreta thekson:- a do të operoni si kompani “Elkon” pasi që ka raste që kompanitë e marrin pëlqimin ndërsa në anën tjeter e shesin. Në vendin që ju po kërkoni pëlqim është ka punohet dhe me çfarë të drejte komuna i ka dhënë pëlqim kompanisë me punuar dhe me investuar a në fakt punimet munden me i shkuar poshtë dhe dëmtohet si biznes . A ka leje biznesi që ka punuar aty apo është duke i kryer punimet pa leje.

Rashid Krasniçi (përfaqësues i kompanisë Elkon) thekson:- nuk e kemi në plan me shitur projektin por kemi me punuar si kompani “Elkon” . Servitutin në këtë parcelë e përfshinë prej asaj pike deri në fund dhe nuk kemi me pas me askënd problem.

Habib Thaçi thekson:- pëlqimi i është dhënë në vitin 2019 nga komuna dhe a është marr përsyshë moratoriumi i ndërtimit të hidrocentraleve që thuhet që pa u bërë analiza e mirëfilltë e kapaciteteve ujore , nuk mundet me u trajtuar procesi i hidrocentraleve më tutje . Duke pasur parasysh vendin që e pashë unë, hidrocentrali i takon zonës një ose dy të hartave zonale dhe në këto zona është e ndaluar me nderuar hidrocentrale por a është marr parasysh ky aspekt se ndoshta mos po bëjmë shkelje ligjore. Nga kompania cilat janë përfitimet tona si komunitet.

Rashid Krasniçi (përfaqësues i kompanisë Elkon) thekson:- moratoriumi vlen ende për tipat tjeter të hidrocentraleve që janë me tubacion. Modeli i tillë i hidrocentraleve është miqësorë me ambientin dhe nuk e dëmton . Do të mbahet debat publikë me komunën dhe Ministrinë e Ambienti për me u dhënë pëlqimi mjedisorë.

Mefail Suma thekson:- që në fillim kisha kërkuar nga parashtruesi i kërkesës që ta ndërron kërkesën dhe të jetë vetëm Hani i Elezit e jo siç e ka shënuar Elez Han për shkak Elez Han quhet në dy gjuhësi. Këtë që e potencuat ju, ana e jashtme nuk po e shprehë përbajtjen e vërtetë. E keni paraqitur erozionin por aj lumë do të rrjedhë dhe si mendoni që ndërprehet erozioni. A mendoni që do t'i ndërrrohet kahja shtratit të lumit Lepenc? A mendoni që do të rritet lumi Lepenc sepse në vitin 1989 deri në hekurudha është rritur lumi Lepenc . A do të ketë siguri për shkak se do të jetë thellë.

Rashid Krasniçi (përfaqësues i kompanisë Elkon) thekson:- sa i përket sigurisë nëse komuna kërkon me thur ne e thurim nuk ka kurfar problemi. Sa i përket erozioni do të qesim gur dhe rregullohet. Në momentin që do të rregullohen dokumentacionet në ministri përkatëse do të aplikojmë për leje në komunë dhe do t'i fillojmë punimet.

Sead Vila thekson:- kompania gjeodezike Gjeohorizontë kush është përfaqësues sepse mos të jetë një person që ka një imazh të keç që po aludojë unë. Përveç dobisë që ka zbulurim a ka edhe ndonjë dobi tjetër ky projekt. Është një zonë shumë e frekuentume dhe duhet me pasur kujdes që mos të dëmtohet pjesa e vendbanimit me pasoj për qytetarët që jetojnë në atë territor. Fréquentohet nga fëmijët dhe duhet të jetë një masë preventive që mos të ketë rreziqe për shkak se shpesh ndodhë që pasi të ndodhin gjërat reagojmë.

Rashid Krasniçi (përfaqësues i kompanisë Elkon) thekson:- unë mendoj që në atë pjesë me bërë një shëtitore dhe në anën e brendshme me thur mos me u rrezikuar askush. Sa i përket kompanisë gjeodezike personalisht e njohë dhe është i këqyr te hidrocentralet në Mitrovicë. Te përfitimet në këtë projekt përparësi do të kenë kompanitë e Hanit të Elezit por do të varet edhe prej ofertuesve. Do të punësohen shtatë apo tetë punëtorë. Do të ndërtojmë një stadium të vogël të futbollit.

Florim Shkreta thekson:- të gjithë potencojnë që përparësi do të kenë kompanitë e Hanit të Elezit dhe pastaj kontraktojnë kompani tjera.

Sabrije Krasniçi thekson:- të gjithë e dinë që fëmijët verës rrinë në atë pjesë të lumit dhe më mirë është me thur e mos me shikuar me zbuluar ambientin por sigurinë e fëmijëve. Gjatë ndërtimit mund të përdoren makineri të rënda dhe nëse dëmtohet asfalti nga kush do të rregullohet.

Rashid Krasniçi (përfaqësues i kompanisë Elkon) thekson:- ata të cilët e bëjnë dëmin do ta kthejnë në gjendje siç ka qenë .

Sabedin Hasallari thekson:- te informata e biznesit jeni i regjistruar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuara me një punëtorë dhe me kapital prej 1000 € . A e keni rritur numrin e fuqisë punëtore dhe vlerën e kapitalit. Rrymën a keni planifikuar me ja shitur KEDS-it.

Rashid Krasniçi (përfaqësues i kompanisë Elkon) thekson:- si kompani është e regjistruar me një punëtorë dhe si referenca mundem mi sjell për hidrocentrale që kemi ndërtuar dhe punëtorët janë kontraktuar si punëtorë sezonal.

Nora Xhoni thekson:- personalisht unë dhe në emër të grupit parlamentarë do të votojmë me kusht që nëse skica ndryshon te ajo pjesa e biznesit privat e jo me u dëmtuar biznesi në mënyrë që në të ardhmen nuk dua me dal probleme.

Rashid Krasniçi (përfaqësues i kompanisë Elkon) thekson:- kur të aplikojmë për leje të ndërtimit do ta definojmë pikën saktë dhe nuk do të preket biznesit për shkak se nuk na pengon për me u zhvendosur më poshtë.

Kryesuesi thekson:- bizneset vendore nuk jam i interesuar me i prekur sepse kafiteria “Bambi” është biznes i qytetarit tonë se e ka zgjeruar biznesit dhe mund të jetë investitorë më i sigurt se kjo kompani që po pretendon. Hidrocentralet janë duke u rishqyrtuar në Qeveri dhe ne në parim mund të i japim pëlqim.

Mehmet Ballazhi thekson:- nuk është çështje ligjore që nëse ne e pengojmë apo e lejojmë sepse ligji na lejon me dhënë pëlqim duke u bazuar në planin zhvillimorë , ndërsa vendimin kryesorë e jep Ministria e Mjedisit por kuvendi mundet ti jep pëlqim në parim. Ne nuk ja kemi ndaluar askujt sepse çdo biznes që është në interes të qytetarëve ja kemi lejuar, mirëpo kompania është mirë ta merr seriozisht këtë çështje e jo vetëm me marr pëlqim dhe me uzurpuar vendin për dy vite . Sa i përket bizneseve vendore nuk jemi për me i penguar për ndryshe si grup parlamentar do ta votojmë.

Nexhemdin Daci thekson:- kompania një herë e ka marr pëlqimin në kuvend dhe i paraqiti arsyet e veta por në parim mirë është me ja dhënë sepse ky lloj i hidrocentralit nuk është sikur hidrocentralet e tjera të cilat e fusin në gyp ujin. Kompania do të pajiset edhe me pëlqime të tjera në Ministrinë përkatëse dhe pastaj do të kërkon leje në komunë për me ndërtuar hidrocentralin.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 13 për , 2 kundër (znj.Sabrije Krasniqi nga grupi parlamentarë i VV-së dhe z.Mefail Suma nga grupi parlamentarë Nisma).

U MIRATUA KËRKESA E KOMPANISË ELKON SHPK PËR DHËNIEN E PËLQIMIT NË PARIM

4. Informatë mbi mbrojtjen e mjedisit.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhemdin Daci thekson:-materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë propozim apo sugjerim mund të parashtroni.

Sead Vila thekson:- është e vërtetë që komuna jonë bënë pjesë një ndër komunat më të ndotura në Kosovë dhe jemi të vetëdijshëm për këtë sepse jemi në një zonë industriale dhe përveç shumë dobive që ka nga industria me punësimin e familjarëve tonë dhe bienfiteve të tjera që mund të ketë si shtet. Ne nuk duhet ta mendojmë vetëm anën pozitive se çka përfitojmë por është mirë që vazhdimisht të japim kritika dhe të bëjmë presione aty ku i bënë dëm shëndetit dhe jetën e qytetarëve në përgjithësi. Kjo temë në komunën tonë është në vazhdimësi dhe do të jetë edhe shumë vite dhe nëse është gjendja pak e përmirësuar është pozitive por nuk do të thotë që është e kënaqshme për shkak se ne e dimë si ka qenë më herët por sot në dukje ndoshta pak është më e mirë . Raporti i kompanisë “Sharrcem ka për qëllim me promovuar vetëm pjesën pozitive dhe ndoshta nuk i shpalosë pjesët negative por si komunë në forma të ndryshme si institucione është mirë që vazhdimisht me i bërë presion që me parandaluar dhe me krijuar një ambient sa më të pastër. Do të ishte mirë që edhe komuna me institucionet tjera me organizuar ndonjë aksion për mbjellje të drunjve , më bërë aktivitetë vetëdijësuese në mënyrë që me ndikuar te vetëdija e qytetarëve që mos me u hedhur mbeturinat në vendet të cilat janë të ndaluara.

Florim Shkreta thekson:- është shqetësim tek ne ndotja e ambientit por deri më sot nuk është ka merret dikush më seriozisht me këtë çështje. Më herët kam këruar që aparatit për monitorimin e cilësisë së ajrit që është i vendosur te shkolla fillore “Ilaz Thaçi” me zhvendosur por nuk është bërë deri më tani. Shifrat të cilat publikohen i tejkalojnë limitet duke u bazuar në dyoksidin e sulfurit , monoksidit të karbonit. Si formula po i shohim por duhet ta dimë se na ku jemi duke thithur oksigen. Prania te grimcat e dyoksidit të sulfurit shkakton ngjyrë të verdhë dhe pakësim të pamjes në ajr. Agjencia ndërkombëtare për kërkim mbi kancerin e klasifikon më kancerogenë ndër të parët. Monoksidi i karbonit ky gazë pa ngjyrë dhe helmues përfitohet prej djegies së karburanteve fosile , kur monoksidi i karbonit hynë në organizëm me anë të frysëmarrjes e bllokon oksigjenin në qarkullim dhe shkon në tru , zemër dhe në organet e tjera jetësore. Oksidet e azotit shkaktojnë irritim në mushkri dhe dobësojnë mbrojtjen e organizmit kundër infeksioneve të rrugëve të frysëmarrjes. Grimcat e ngurta pm10 dhe pm 2.5 janë forma që shkaktojnë vdekje në ajrin e ndotur për shkak të aftësisë së tyre për të depërtuar thellë në mushkri dhe sistemin e qarkullimit të gjakut duke e

shkaktuar në rastet më ekstreme mutacione të përherershme gjenetike arrest kardiak dhe vdekje të parakohshme. Grupet më të prekura prej këtyre grimcave janë ato me sëmundje të zemrës dhe mushkërive , personat e moshuar dhe fëmijët. Ozoni mund të shkakton probleme të shumta të shëndetit si sëmundjet e asmës , bronëhiti dhe këto substanca mund të shkaktojnë lindje me defekte dhe kancer . Është shqetësim tek ne si trevë dhe i kisha propozuar kryetarit tonë që sa bënë filma apo që i bënë qef vetës që tregon se kur zgjohet në mëngjes dhe ka ju ka shtruar asfalt bagëtive në bjeshkë më mirë do të kishte qenë të merret me këto probleme edhe pse ndoshta të gjitha nuk kishim mundur me i eliminuar por dikund dikund kishim mundur me përmirësuar ndotjen.

Hanumshahe Dibrani thekson:- gati se në çdo mbledhje kemi diskutuar për ndotjen e ambientit dhe për erën e rëndë që shkaktohet nga kompania “Sharrcem” dhe është mirë që të merren masa. Problemi është i madh edhe te parkingu që është afër shkollës filllore “Ilaz Thaçi” për shkak se kamionët po e ndotin ambientin dhe komuna duhet të bënë pastrimin e rrugës. Te ura e Seçsishtë janë hedhur mbetje të azbestçimentos dhe mendoj që janë kancerogjene.

Habib Thaçi thekson:- në raport shihen disa përmirësime që i ka bërë kompania “Sharrcem” , mirëpo ne duhet vazhdimisht me parë përmirësime qoftë përmes fileterëve apo në çdo aspekt që ndihmon në çështjen e ambientit. Një kohë të gjatë punëtorët punojnë në kompania “Sharrcem” dhe kemi vërejt që një pjesë e tyre kanë probleme me kancerin në mushkëri dhe me sëmundje të ndryshme dhe komuna duhet të bisedon me personat përgjegjës që personat të cilët janë diagnozë të kancerit tu bëhet një kompensim financiarë këtyre familjeve për shkak se marrja e dozave është shumë e shtrenjtë . Apelojë që komuna ta paraqet këtë çështje te kompania dhe ta harton një listë që secili person nga komunitet që ka problem dhe dëshmon me dokumentacione të mjekut që është i sëmurë nga kanceri me bërë kërkësë në kompani që të kompensohet me jete financiare për shërimin e atij personi. Është mirë që të caktohen pjesët e qytetit ku ndotja është më e madhe për shkak se nëse sot e pastron veturën , të nesërmen është e papërdorshme në aspektin e pastërtisë dhe duhet përsëri me pastruar. Për ato persona ku ndotja është më e madhe me u pajisur me kartela që me i pastruar veturat dhe shpenzimet me kryer kompania “Sharrcem”.

Nexhemdin Daci thekson:- është gabim shumë i madh nëse mendojmë që vetëm kompania “Sharrcem” është ndotës i ambientit por unë mendoj që ka edhe tjera që e ndotin ambientin duke filluar prej gurëthyesve , magjistralja, terminali doganorë , dy apo tre parkingje të pa rregulluara, gjatë sezonës dimërorë përdoret masa drusore dhe nuk mundemi me shkuar dhe mi thënë për personat të cilët janë të sëmur me kancer sepse nuk mundemi me konstatuar se ajo sëmundje i ka ardhur prej kompanisë “Sharrcem” . Parkingu i kamionëve që është te shkolla filllore “Ilaz Thaçi” është problem i madh por në këtë javë jemi marr vesh që definitivisht me mbyllur. Në përgjithësi në brigjet e limit Lepenc ka mbetje të azbestçimentos por e kemi projektin e rregullimit të limit Lepenc që do të investon banka botërore nëse qeveri i jep garancion do të realizohet për shkak se është investim i madh.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të parapri sipas agjendës.

3. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mefail Suma thekson:- propozoj që te varrezat e dëshmorëve me ndërtuar në stilin dorik , shtyllat e para diametri të jetë 50 cm me hullija dhe me brenga , pastaj lartë harku të jetë në fromë ashtu siç e rrokë kompasi dhe të jetë pesëdhjetë me pesëdhjetë dimensioni , porta brenda të jetë çfarë do dhe lartë me hap konkurs dhe dikush me shënuar një citat për varrezat e dëshmorëve. Un e paraqita si propozim ideorë.

Nexhemdin Daci thekson:- ju mund ta paraqitni përmes vizatimit dhe ta dorëzoni në drejtorin e urbanizmit.

Florim Shkreta thekson:- stafi që është pranuar në çerdhe a është trajnuar për shkak se punët dhe gjërat e brendshme mos me i diskutuar jashtë atij objektit sepse ka ankesa nga qytetarët që për problemet e një fëmije po dalin fjalët dhe po diskutohen nëpër rrugë apo nëpër kafene të ndryshme. Kjo është gjë e ndishme dhe nëse vazhdon kjo punë kështu mund të vjen deri te mbyllja e çerdhes. E paraqita këtë për shkak se është shqetësim i qytetarëve.

Mehmet Ballazhi thekson:- është mirë që me diskutuar çështjen e kamionëve që po bëhet kolonë dhe duhet në mbledhje të KKSBB-së me marr një iniciativë më serioze në mënyrë që të krijohet një mundësi e lëvizjes më e shpejtë për shkak se ka raste që ka urgjencia për punë të ndryshme dhe po mbesim keç.

Sabedin Hasallari thekson:- te pllaka përkujtimore “Bllaca” të bëhet rrethoja për shkak se po kullosin bagëtitë. Të vendosen pengesa në rrugë te kompania e ime për shkak se ajo rrugë është bërë shumë e frekuentuar dhe po ka vozitje të shpejta.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen e kuvendit të komunës. Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:55.

Procesmbajtësi

Avní Bushi

